Liria e Shprehjes dhe e Medias në Shqipëri (JUFREX)

Cili është objektivi?

- Të promovojë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në Shqipëri në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës;
- Të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit tek gjyqësori, profesionistët ligjorë, dhe oficerët e policisë rreth të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive të aktorëve të medias të përcaktuara sipas standardeve evropiane dhe t'i zbatojnë ato në rastet e tyre në praktikë;
- Të forcojë kapacitetet profesionale dhe pavarësinë e Autoritetit Rregullator të Medias që të kontribojë në ushtrimin e rolit të tij për mbrojtjen e lirisë së medias;
- Të krijojë një mjedisi mediatik më të sigurt, më pluralist dhe ku aktorët e mediave janë më të ndërgjegjshëm për kufijve e tyre etikë.

Kush përfiton nga projekti?

- Institucionet kombëtare të trajnimeve për profesionistët ligjorë sikundër Shkolla e Magjistraturës dhe Dhoma e Avokatisë;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);
- Këshilli Shqiptar i Medias, ResPublica, Fakulteti i Drejtësisë dhe Gazetarisë;
- Profesionistë të fushave si gjyqtarë, prokurorë, oficerë policie, juristë, gazetarë, palë të tjera të interesuara në fushën e medias, studentë universitarë, dhe në fund shoqëria shqiptarë në tërësi.

Si do të funksionojë projekti?

- Projekti aktual bazohet në rezultatet e arritura gjatë një programi të përbashkët të mëparshëm rajonal të BE/KiE "Përforcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe mediat në Evropen Jug-Lindore (JUFREX) 2016-2019;
- Aktivitetet kapacitgritës për kategoritë e ndryshme profesionale do të kryhen sipas një metodologjie interaktive të mësimit të moshave të rritura dhe modelit nga kolegu në koleg (*peer-to-peer*), ndërsa ndërlidhja e fortë ndërmjet projektit rajonal dhe atyre lokalë garanton forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe mësimeve që dalin;
- Projekti përdor një qasje gjithëpërfshirëse me qëllim vendosjen e një dialogu ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe palëve të ndryshme të interesit;
- Projekti është i strukturuar mbi bazën e tre komponentëve që synojnë grupe specifike: (I) gjyqësorit, profesionistëve ligjorë dhe agjencive ligj-zbatuese; (II) Autoriteti Rregullator i Mediave; (III) gazetarët dhe palëve të tjera të interesuara të medias dhe studentë.

Çfarë presim të arrijmë?

- Përmirësimin në zbatimin e standardeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias nga ana e gjyqsorit, projesionistët ligjorë dhe oficerët e policisë;
- Forcim të kapaciteteve profesionale të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqiptar dhe rritje të besueshmërisë nga ana e komunitetit të mediave ndaj AMA për sa i përket ruajtjes së lirisë së medias duke garantuar njëherazi pavarësi dhe paanshmëri;
- Ofrimi i kontributit nga palët e interesuara të fushës së medias, anëtarët e parlamentit, universitetet, dhe palët e tjera të interesit për mundësimin e një mjedisi të përshtatshëm për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias.

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës

INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË 2019-2022

PËR TË DREJTAT TUAJA: DREJT STANDARDEVE EVROPIANE

Sa do të kushtojë?

- Buxheti total i projektit: 415,000 EUR;
- Buxheti për gjithë programin e Instrumentit Horizontal: 41 milionë EUR (85% i financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli Evropës).

Si të merrni më shumë informacion?

- Drejtoria e Përgjithshme I: të Drejtat e Njeriut dhe Ligjshmëris: https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/jufrex-2
- Cesare Pitea, Menaxher Programi, Cesare.PITEA@coe.int, +333 90 215 076
- Erkanda Bujari, Oficere Projekti, Erkanda.BUJARI@coe.int, +355 44540223
- Faqja e internetit e Instrumentit Horizontal: https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home
- Marija Simić, Oficere Komunikimi e Instrumentit Horizontal, Marija.SIMIC@coe.int, +381 63 601 337
  Besnik Baka, Oficer Komunikimi i Instrumentit Horizontal, Besnik.Baka@coe.int, +355 69 217 8430

Rreth Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u mundëson përfituesve të përmbushin agjendat e tyre të reformës në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe përputhjen me standardet evropiane, duke përfshirë aty ku është e nevojshme çështjet në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar mbulon projekte në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi, si dhe në Kosovë * dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës prej majit 2019.

**Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimin në lidhje me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.*

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t`i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

www.europa.eu

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale.

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës